



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

V E N D I M

Nr. 60, Datë 13/04/2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 43, datë 23.03.2021, e Fondacionit “Së Bashku”, përfaqësuar nga znj. S.L., Drejtore Ekzekutive e këtij fondacioni, ku pretendohet diskriminim i personave me aftësi të kufizuar, për shkak të “*aftësisë së kufizuar*”, nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri¹,

K O N S T A T O I:

1. Pretendimet e subjektit ankues.

Pretendimi i subjektit ankues, për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, të të gjithë individëve që kanë një aftësi të tillë, konsiston në faktin se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore nuk kanë marrë masa për garantimin e së drejtës për të votuar për këta individë, në zgjedhjet kombëtare, që do të zhvillohen në datën 25.04.2021.

Sipas ankesës në fjalë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar Udhëzimin nr. 1, datë 05.12.2020 “*Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit për përgatitjen e hartës së njësive të vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet*”

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

për Kuvend të datës 25 prill 2021”, i cili përcakton rregullat për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe ndër të tjera ka përcaktuar dhe masat që duhen marrë për garantimin e të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara. Sipas ankesës në fjalë, neni 3, pikat 1 dhe 2, të Udhëzimit kanë përcaktuar kriteret për përcaktimin dhe ngritjen e qendrave të votimit, që janë përkatësisht: (1) qendrat e votimit krijohen për aq sa është e mundur në ndërtesa publike me hyrje të lirë; (2) mjedisi i qendrës së votimit, si rregull, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtëme: të jetë me sipërfaqe jo më të vogël se 30 m²; të jetë sa më afër qendrës gjeografike të zonës së qendrës së votimit; të ketë ndriçim të mjaftueshëm; të jetë në katet e para të objekteve.

Në ankesë sqarohet se në nenin 5, të Udhëzimit të sipërcituar janë përcaktuar kriteret teknike dhe pajisjet e qendrës së votimit, si vijojnë:

“1. Mjedisi i qendrës së votimit, si rregull, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtëme:

- a) Të jetë me sipërfaqe jo më të vogël se 30 m²;*
- b) Të jetë sa më afër qendrës gjeografike të zonës së qendrës së votimit;*
- c) Të jetë me ndriçim të mjaftueshëm;*
- d) Të jetë në katet e para të objekteve.*

2. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masa për:

- a) Pajisjen e QV-së me tavolina, karrige apo pajisje të tjera, të mjaftueshme për anëtarët e KQV-së dhe vëzhguesit, sipas skemës tip të plan vendosjes, bashkëlidhur këtij udhëzimi;*
- b) Krijimin e lehtësirave për votimin e personave me aftësi të kufizuara;*

Fondacioni “Së Bashku” vë në dukje faktin se krijimi i lehtësirave për votimin e personave me aftësi të kufizuara është lënë në diskrecion të Kryetarit të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore, fakt të cilin nuk e mbështet, pasi sikurse theksohet në ankesë, nga monitorimi që është kryer në zgjedhjet e mëparshme, pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara ka qenë shumë e ulët dhe arsyeja kryesore ka qenë mungesa e kushteve në qendrat e votimit për t’iu mundësuar ushtrimin e të drejtës së votës personave me aftësi të kufizuara. Në ankesë theksohet fakti se, kushtet që duhet të ketë qendra e votimit fillojnë që nga mundësia e aksesimit në të (ekzistenca e rampave me kushtet e duhura teknike), ekzistenca e një hyrjeje alternative për personat me aftësi të kufizuara, ambiente të lirshme për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara, vendparkimi për personat me aftësi të kufizuara, ambiente të lirshme brenda qendrës, që të mund të ushtrojnë të drejtën e votës etj.

Subjekti ankues sqaron se nëpërmjet shkresës nr. 1735/1, datë 13.03.2021, së KQZ-së rezulton se vetëm për Qarkun Durrës janë raportuar në listën e zgjedhësve për zgjedhjet e kuvendit të datës 25.04.2021, 1355 persona me aftësi të kufizuara dhe 700 të verbër (në total 2055 persona), si votues.

Për sa më sipër, Fondacioni “Së Bashku” pretendon se udhëzimi i sipërcituar nuk garanton kushtet për ushtrimin e të drejtës së votës nga personat me aftësi të kufizuar në zgjedhjet e datës 25.04.2021 dhe kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar, për të gjithë këta individë.

2. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

A. Pas analizimit paraprak të ankesës së Fondacionit “Së Bashku”, përfaqësuar nga znj. S.L., Drejtore Ekzekutive e këtij fondacioni, KMD konstatoi se:

Në ankesën nr. 43, datë 23.03.2021, e Fondacionit “Së Bashku”, përfaqësuar nga znj. S.L., Drejtore Ekzekutive e këtij fondacioni, pretendohet diskriminim i personave me aftësi të kufizuar, për shkak të *“aftësisë së kufizuar”*, nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Për sa më sipër, Fondacioni “Së Bashku” pretendon se Udhëzimi nr. 1, datë 05.12.2020, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, *“Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit për përgatitjen e hartës së njësive të vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”* është diskriminues, pasi sipas këtij akti, krijimi i lehtësirave për votimin e personave me aftësi të kufizuar është lënë në diskrecion të Kryetarit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore. Fondacioni sqaron se nga monitorimi që është kryer në zgjedhjet e mëparshme, pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuar ka qenë shumë e ulët dhe arsyeja kryesore ka qenë mungesa e kushteve në qendrat e votimit për t’iu mundësuar ushtrimin e të drejtës së votës personave me aftësi të kufizuara.

Në ankesë theksohet fakti se, kushtet që duhet të ketë qendra e votimit fillojnë që nga mundësia e aksesimit në të (ekzistenca e rampave me kushte teknike), hyrja alternative për personat me aftësi të kufizuar, ambiente të lirshme për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuar, vendparkimi për personat me aftësi të kufizuara, ambiente të lirshme brenda qendrës, që të mund të ushtrojnë të drejtën e votës etj.

Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:

Konventa e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*² në mënyrë të posaçme në nenin 4/1, ka përcaktuar se: *“Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe promovojnë realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar pa diskriminim të ndonjë lloji me bazë aftësinë e kufizuar.”*

²Ratifikuar me ligjin nr 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

Në frymën e Konventës, është miratuar gjithashtu edhe ligji nr. 93/2014 “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara*”, i cili ka si qëllim, të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre, të barabartë në shoqëri.

Persona me aftësi të kufizuara, sipas këtij ligji, janë, individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

Jetesa e pavarur, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Neni 5, pika 2, gërma g) e ligjit nr. 93/2014 “*Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara*”, përcakton gjithashtu se, politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuar që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës e ndër të tjera të kenë akses në jetën politike dhe publike, si zgjedhës dhe të zgjedhur.

Në kontekstin e mësipërm, edhe ligji nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “*aftësisë së kufizuar*” duke përcaktuar se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Neni 3, i ligjit nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë,

me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në nenin 20, pika, 3), të LMD, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet për një person fizik ose juridik, që ofron të mira dhe shërbime për publikun, të mos pranojë ose të kundërshtojë realizimin e ndryshimeve ose përshtatjeve të nevojshme dhe të duhura, të cilat synojnë të mundësojnë përfitimin e këtyre të mirave dhe shërbimeve nga një person me aftësi të kufizuara, për sa kohë që këto modifikime apo përshtatje nuk imponojnë një barrë të shpërpjesëtuar ose të paligjshme mbi personin që ofron të mirat dhe shërbimet.”*

Lidhur me ankesën nr. 43, datë 23.03.2021, e Fondacionit “Së Bashku”, Komisioneri gjykon se ky fondacion pretendon për diskriminim të kategorisë së personave me aftësi të kufizuara, nga ana e Udhëzimit të sipërcituar, ndërkohë që në këtë akt është parashikuar shprehimisht fakti që Kryetarët e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore duhet të marrin masa për krijimin e lehtësirave për votimin e personave me aftësi të kufizuara. Krijimi i këtyre lehtësirave është i vetëkuptueshëm, që duhet marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi, i cili parashikon hollësisht se cilat janë këto lehtësi dhe si duhen realizuar ato. Njëkohësisht, ky Fondacion nuk ka depozituar asnjë fakt dhe provë që të mbështesë pretendimet e tij se Kryetarët e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore realisht nuk i kanë marrë masat përkatëse, për krijimin e kushteve të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, për zgjedhjet kombëtare të datës 25.04.2021. Mosbesimi i kësaj shoqërie ndaj kryetarëve mbështetet në monitorimet e kryera³ në qendrat e votimit, si dhe në pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në zgjedhjet e kaluara, të zhvilluara para 4 vitesh, ndërkohë që nuk ka informacion konkret mbi qendrat e votimit për zgjedhjet aktuale.

Në këto kushte diskriminimi i pretenduar nga fondacioni është hipotetik dhe abstrakt dhe nuk lidhet me konstatime konkrete të shkeljes të të drejtave të qytetarëve.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, gërma ç), të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, Komisioneri

³ Në këtë kontekst, nuk përmendet emërtesa e asnjë monitorimi të kryer dhe rezultatet përkatëse të tij, që mbështet pretendimin e Fondacionit.

gjykon se ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma c), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nëpërmjet Urdhërit nr. 45, datë 09.04.2021, të KMD, “Për fillimin e procedurave për ndjekjen ex-officio të çështjes, lidhur me plotësimin e detyrimeve ligjore për sigurimin e aksesit fizik dhe lehtësirave të tjera, për personat me aftësi të kufizuara, në qendrat e votimit, për zgjedhjet kombëtare që do të zhvillohen në datën 25.04.2021”, Komisioneri ka filluar shqyrtimin kryesisht të çështjes, për të hetuar dhe monitoruar Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, lidhur me plotësimin e detyrimeve përkatëse ligjore nga ana e tyre, për sa i përket sigurimit të aksesit dhe lehtësirave të tjera ndaj personave me aftësi të kufizuara, në të gjitha qendrat e votimit për zgjedhjet kombëtare të datës 25.04.2021. Çështja ex-officio konsiston në kryerjen një hetimi dhe monitorimi të përgjithshëm nga ana e KMD-së, në të gjitha bashkitë e Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 7, nenin 20, pikat 1 e 2, gërma c), nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma ç), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 43, datë 23.03.2021, të Fondacionit “Së Bashku”, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja djeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha – Shërbime
Shkak – aftësi e kufizuar
Lloji i vendimit - mospranim